



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Fëmijëve

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 202300899/6

Tiranë ___/___/2024

Lënda: Rekomandim për krijimin e mjediseve të përshtatshme për edukim, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës së shkollave 9-vjeçare "Adem Bedalli" dhe Bishqem, të Peqinit

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT

TIRANË

BASHKISË PEQIN

PEQIN

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

KORÇË

Për dijeni:

ZYRËS VENDORE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PEQIN

Të nderuar,

Institucioni i Avokatit të Popullit është vënë në dijeni, nëpërmjet publikimit në median *online*, të gjendjes së vështirë të infrastrukturës të godinës së shkollës më të vjetër në qytetin e Peqinit, shkollës 9-vjeçare "Adem Bedalli", si dhe të shkollës 9-vjeçare Bishqem në Peqin.

Në artikull përshkruhej gjendja si "...Suva të rëna, mure të plasaritura, tavolina dhe karrige të shkatërruara, klasa pa dyer dhe dritare, tualetet jashtë shkollës dhe pa ujë, në gjendje të mjerueshme. Por edhe pse kjo shkollë ka mirëpritur këtë vit shkollor plot 400 nxënës, nuk është marrë asnjë masë për të dhe arsyeja është "nuk ka buxhet"...".

Sipas këtij raportimi në media, kushtet dhe gjendja e godinës së këtyre shkollave janë të papranueshme për shëndetin e fëmijëve, por edhe të stafit mësimdhënës. Në mbështetje të nenit 13, të ligjit nr.8454, datë 4.02.1999, "Për Avokatin e Popullit", të ndryshuar, Avokati i Popullit filloi procedurën e shqyrtimit të çështjes me nismën e vet, për rastin e veçantë të bërë publik, pasi konstatoi shkeljen e së drejtës së fëmijës për arsim dhe kushte të pranueshme për një nxënie dhe edukim efektiv.

Në zbatim të shkronjës "b", të nenit 19, të ligjit nr. 8454/1999, Avokati i Popullit u kërkoi informacion zyrtar institucioneve vendore, që e kanë në kompetencën e tyre zgjidhjen e problematikës.

Referuar informacionit të dërguar nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Peqin (ZVAP)¹, për krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për këtë vit shkollor, kjo zyrë i është drejtuar me shkresë zyrtare² Bashkisë Peqin "Kërkesë për krijimin e kushteve në institucionet e arsimit parauniversitar për fillimin e vitit 2023-2024", si dhe me anë të komunikimit të përditshëm verbal, duke kërkuar ndërhyrje emergjente ose ndërtimin nga e para të shkollës 9-vjeçare "Adem Bedalli" Peqin. Gjithashtu, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Peqin i ka dërguar shkresë zyrtare Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë, me nr.497 prot., datë 14.09.2023, "Informacion narrativ mbi gjendjen infrastrukture të institucioneve arsimore në varësi të ZVAP Peqin".

Shkolla 9-vjeçare "Adem Bedalli" Peqin i ka drejtuar Bashkisë Peqin, dhe për dijeni ZVA Peqin³, kërkesën për ndërhyrjet në infrastrukturën e godinës së shkollës, për fillimin e vitit shkollor 2023-2024. Po ashtu, edhe shkolla 9-vjeçare Bishqem i është drejtuar me kërkesën përkatëse Bashkisë Peqin dhe për dijeni ZVAP Peqin, për fillimin e vitit shkollor 2023-2024. Kjo korrespondencë shkresore realizohet mes këtyre institucioneve në çdo fillim viti shkollor.

¹ Shkresa me nr.6211/1 prot., datë 04.11.2023

² Referuar me shkresën nr.320 prot., datë 04.07.2023 "kërkesë për krijimin e kushteve në institucionet e arsimit parauniversitar për fillimin e vitit shkollor 2023-2024

³ Shkresa e fundit, me nr.18/4 prot., datë 22.06.2023

Rezulton se nga ana e shkollës 9-vjeçare Bishqem i është dërguar shkresë zyrtare⁴ Bashkisë Peqin “kërkesë për bazë materiale”, në të cilën është kërkuar edhe plotësimi me sanitare. Për sa i përket rastit të shkollës 9-vjeçare Bishqem, ZVAP Peqin, informon se është detyrë e Bashkisë Peqin pajisja e shkollave me sanitare.

Pra për fillimin e këtij viti shkollor të dyja shkollat, shkolla 9-vjeçare Bishqem edhe shkolla 9-vjeçare “Adem Bedalli” i kanë kërkuar Bashkisë Peqin, dhe për dijeni ZVAP Peqin, ndërmjet të tjerash dhe si më emergjentet, respektivisht:

-Shkolla 9-vjeçare Bishqem e përbërë nga dy kate, 14 klasa dhe 2 tualete në çdo kat, kërkon një sanitare për shkollën, pasi ka 210 nxënës dhe 21 mësues⁵.
-Shkolla 9 vjeçare “Adem Bedalli”, përveç bazës materiale për shkollën, ka parashtruar nevojën për lyerje të ambienteve e sidomos të klasave, në kushtet kur tavanet e disa klasave kanë rënë, gjendja e tualeteve është shumë e keqe, muri i dy klasave të shkollës është i çarë dhe ka nevojë për ndërhyrje urgjente, pasi rrezikohet jeta e fëmijëve⁶.

Pra numri i nxënësve që frekuentojnë këto dy shkolla është 410 nxënës, respektivisht:

Shkolla 9-vjeçare Bishqem-210 nxënës

Shkolla 9-vjeçare “Adem Bedalli”-200 nxënës

Bashkia Peqin e ka informuar Avokatin e Popullit⁷ se “... ka ndarë paketën me materiale për sanitaret, si dhe materiale të tjera për të gjitha shkollat e Bashkisë Peqin. Në lidhje me mungesën e sanitarëve në shkollat e fshatrave të Peqinit në 12 shkolla 9-vjeçare, edhe këtë vit, Drejtoria e Financave nuk ka buxhete për të punësuar 12 sanitare të reja, sepse kjo bashki nuk ka burime natyrore apo renta minerare që të fitojë buxhet nga taksat e tarifatat vendore, si dhe nga granti vjetor i buxhetit që i akordohet Bashkisë Peqin nga Ministria e Financave, nuk e mbulon strukturën aktuale të punonjësve. Sanitaret në tre shkollat dhe kopshtin e Peqinit paguhet nga buxheti që vjen nga Ministria e Arsimit. Gjithsesi Bashkia e Peqinit do të shikojë mundësitë financiare në vitet në vijim për të punësuar sanitare në shkollat rurale. Në lidhje me shkollën “Adem Bedalli” të qytetit të Peqinit ku mësojnë 200 nxënës, ajo

⁴ Shkresa me nr.484 prot., datë 26.06.2023 “Kërkesë për bazë materiale”

⁵ Shkresa me nr.484 prot., datë 26.06.2023

⁶ Shkresa me nr.18/4 prot., e datës 22.06.2023

⁷ Shkresa e Bashkisë Peqin, Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Sportit dhe Trashëgimisë Kulturore, me nr.1962/1 prot., datë 30.10.2023

përbëhet nga dy godina dy katëshe të ndërtuara në vitin 1952, godina përpara, si dhe godina mbrapa e ndërtuar në vitin 1958, të dyja tejet të amortizuara me gjithë ndërhyrjet me investime të vogla e të pjesshme ndër vite nga Bashkia Peqin. Nga Zyra Arsimore Peqin dhe drejtoria e shkollës “Adem Bedalli që në vitin 2004 është kërkuar një godinë e re shkollore. Nga Bashkia Peqin informohet gjithashtu, që kryetari i kësaj bashkie që në mbledhjen e parë të muajit qershor 2023 ka diskutuar për një *kërkesë prioritare dhe emergjente për një godinë të re të shkollës “Adem Bedalli”*, për t’ju drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, për planifikimin buxhetor për vitin 2024.

Evidentojmë faktin që nga ana e kësaj bashkie, është paraqitur kërkesa për ndërhyrje emergjente në godinën e shkollës 9-vjeçare “Adem Bedalli” Peqin⁸, drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë. Po ashtu, nga ana e kësaj bashkie i është paraqitur kërkesë Institutit të Ndërtimit Tiranë, për vlerësimin teknik të godinës së shkollës 9-vjeçare “Adem Bedalli”⁹, si një godinë që paraqet rrezikshmëri të lartë, si pasojë e amortizimit, problemeve hidroizoluese dhe dëmtimeve të pësura nga fenomenet natyrore ndër vite.

Vetë Bashkia Peqin, Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, në akt-konstatimin e datës 12.10.2023, pas verifikimit në terren të objekteve, ka evidentuar se si ambientet e jashtme, ashtu dhe ato të brendshme të godinave paraqesin probleme të theksuara të amortizimit. Si rezultat i depërtimit të lagështirës, kati i dytë i ndërtesës është tërësisht jashtë funksionit. Në të gjitha klasat konstatohen krisje dhe çarje të mureve dhe tavaneve. Kjo situatë vjen duke u përkeqësuar ditë pas dite dhe në rast mosndërhyrjeje mund të ketë dhe pasoja shëndetësore për nxënësit dhe stafin. Tualetet nuk plotësojnë kushtet minimale higjeno-sanitare dhe janë jofunksionale. Për të shmangur çdo fatkeqësi të mundshme nga gjendja aktuale e shkollës, kërkohet ndërhyrja e menjëhershme nga organet kompetente, pasi sipas vlerësimit të specialistëve, shkolla nuk është funksionale¹⁰.

Financimi për shkollat përcaktohet në nivel qendror dhe menaxhohet në nivelin rajonal dhe vendor. Fondet vijnë nga buxheti qendror pranë DRAP-eve dhe ZVAP-ve, por fondet e tjera qendrore administrohen nga NJQV-të. Buxhetet e DRAP-eve dhe ZVAP-ve mbulojnë kostot e shumicës së shërbimeve në arsim (p.sh., pagat e mësuesve) dhe janë përgjegjëse për ndërtimin, infrastrukturën, mirëmbajtjen dhe shërbimet¹¹. Pra, organet

⁸ Shkresa me nr.1867 prot., datë 12.10.2023

⁹ Shkresa nr.1867 prot., datë 12.10.2023

¹⁰ Shkresa nr.1864 prot., datë 12.10.2023

¹¹ Ligji nr.69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar

përgjegjëse vendimarrëse në lidhje me burimet financiare për shkollat janë ministria, drejtoritë rajonale, zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Ministria e Arsimit dhe Sportit është përgjegjëse për arsimin në tërësi për të siguruar arsim për të gjithë, duke përfshirë drejtësinë, barazinë dhe aksesin mosdiskriminues për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët që u përkasin pakicave kombëtare.

Bashkitë kanë kompetencë të plotë për të siguruar mirëmbajtjen dhe funksionimin e të gjitha ambienteve të arsimit parauniversitar në komunitetin e tyre. Fondet për mirëmbajtjen dhe funksionimin e ambienteve të arsimit parauniversitar janë të përfshira në burimet e veta vendore. Çdo bashki vendos nivelin e financimit që ajo akordon për këtë funksion, nga të gjitha burimet e disponueshme në buxhetin e tyre. Ministria përgjegjëse për arsimin dhe shkencën përgatit dhe nxjerr standarde kombëtare të sigurisë dhe të shëndetit, të zbatueshme për ambientet e arsimit parauniversitar. Këto standarde nuk duhet të kufizojnë vendimmarrjen e bashkive në fushat me interes të qartë vendor. Shpenzimet e lidhura me funksionimin dhe mirëmbajtjen e mjediseve të arsimit parauniversitar miratohen si pjesë e buxhetit të çdo njësie të vetëqeverisjes vendore. Njësitë e qeverisjes vendore mund të përfitojnë fonde nga ministria përgjegjëse për arsimin për investime në arsimin parauniversitar. Gjithashtu, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të financojnë edhe nga të ardhurat e veta investime në arsimin parauniversitar. Njësitë e vetëqeverisjes vendore respektojnë standardet kombëtare të vendosura nga ministria përgjegjëse për arsimin, e cila nëpërmjet strukturave të saj, monitoron, vlerëson dhe kontrollon zbatimin e standardeve¹² të vendosura nga ajo për rikonstruksion, ndërtim dhe pajisje të ambienteve të arsimit parauniversitar¹³.

Për sa më sipër, MAS dhe institucionet e varësisë për sektorin e arsimit, të cilat kanë në themel të punës së tyre ndërtimin e një sistemi arsimor gjithëpërfshirës, i cili trajton me sukses nevojat individuale të të gjithë fëmijëve, nxënësve e studentëve, duke i trajtuar ata në mënyrë të barabartë dhe me respekt për diversitetin duhet të ndërgjegjësohen, se pa rritur investimet në arsim do të jetë e vështirë që të arrihen rezultate të konsiderueshme të të nxënimit për brezin e ri.

¹² Standartet e miratuara nga MAS me Udhëzuesin “Për projektimin e ndërtimeve shkollore, normat dhe standardet”, “https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Norma_Dhe_Standarte_projektimi.pdf”

¹³ Pika 121 dhe 123 e Udhëzimit nr.9, datë 20.3.2018, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Autoritetet publike dhe jopublike duhet të kenë në konsideratë parësore interesin më të lartë të fëmijës në të gjitha veprimet dhe vendimet që merren në lidhje me ta¹⁴. Roli i arsimit është parësor për çdo vend që synon një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, kulturor dhe social. Kësisoj, komponenti i arsimit dhe edukimit gjatë gjithë jetës, është vendimtar në ndërtimin e një shoqërie të denjë.

Në funksion të zbatimit të parimit të interesit më të lartë të fëmijës, për t'i ofruar një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social¹⁵, si dhe në mbështetje të pikës 11, të nenit 23, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, bashkitë janë përgjegjëse në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, për ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar. Referuar kuadrin ligjor për pushtetin vendor, bashkitë ofrojnë edhe shërbime për organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, si dhe zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve¹⁶.

Institucionet kanë detyrimin të sigurojnë, që fëmijët dhe të rinjtë të trajtohen si duhet në shkollë dhe, të drejtat e tyre njerëzore të mos shkelen, kjo me qëllim ofrimin e kushteve të përshtatshme për realizimin nga fëmijët/nxënës të veprimtarive me karakter sportiv, edukativ, kulturor e dëfryes, në mjediset shkollore, në përshtatje me moshën e tyre¹⁷.

Ekzistenca e godinës dhe mirëfunksionimi i mjediseve të brendshme të saj, me mjetet dhe pajisjet e duhura dhe të nevojshme, është parakusht për zhvillimin korrekt dhe sipas standardeve të procesit të edukimit/arsimimit dhe aftësimin fizik të fëmijëve/nxënës, siç është i rëndësishëm dhe vlerësimi i tyre, në bazë të mjeteve dhe pajisjeve të përshtatshme e të përcaktuara në programin mësimor¹⁸. Arsimimi i fëmijës duhet të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës¹⁹. Po ashtu, investimi në godinat e mjedise shkollore shërben si parapritë dhe masë kundër uljes së numrit të nxënësve në shkolla e shpopullimit të zonave rurale. Edhe në Strategjinë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 evidentohet se “...pavarësisht përmirësimeve, infrastruktura shkollore nuk i plotëson standardet e përcaktuara nga shteti. Ndërkaq, për shkak të hapësirës së

¹⁴ Pika 2, e nenit 6, të ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

¹⁵ Në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Kombet e Bashkuara kanë shpallur që moshë e fëmijërisë ka të drejtë për një përkujdesje dhe përkrahje të veçantë, e transpozuar kjo, edhe dhe në pikën 3, të nenit 6, të ligjit 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

¹⁶ Neni 25, i ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar

¹⁷ Shkronja “c”, e pikës 2, të nenit 19, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

¹⁸ “Program mësimor” është dokumenti që përmban synimet, objektivat dhe rezultatet e të nxënës, metodologjitë e të nxënës dhe të vlerësimit për një lëndë ose fushë të caktuar.

¹⁹ Shkronja “a”, e nenit 29, e Konventës të OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijës.

pamjaftueshme shkollore, në zonat urbane ka mbingarkesë të klasave me nxënës”²⁰.

Nenet 3, 21 dhe 22, të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, parashikojnë se: “... *arsimi parashkollor dhe ai bazë synojnë zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo fëmije, ushtrimin e rregullave themelore të sjelljes e të higjienës, kultivimin e vlerave, si dhe përgatitjen për arsimin fillor, zhvillimin shoqëror, intelektual e fizik, të çdo nxënësi, zotërimin e rregullave të sjelljes dhe kultivimin e vlerave, përkujdesjen për shëndetin, si dhe përgatitjen e mjaftueshme për vazhdimin e arsimit të mesëm të lartë ose për tregun e punës...*”.

Ndërkaq, institucionet shtetërore përgjegjëse duhet të marrin masa konkrete që të inkurajojnë, motivojnë dhe të rrisin cilësinë e arsimit të fëmijëve/nxënës, nëpërmjet krijimit të kushteve të nevojshme infrastrukturore, si dhe ofrimit të mjeteve të domosdoshme mësimore²¹, me qëllim edukimin dhe aftësimin e fëmijëve. Kjo e drejtë themelore dhe e patjetërsueshme shkon paralelisht edhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (konkretisht objektivi 4.1), i cili pohon rëndësinë e sigurimit të një arsimit gjithëpërfshirës, me cilësi të barabartë dhe promovimin e mundësive të të mësuarit përgjatë gjithë jetës. Autoritetet shtetërore deri në vitin 2030, duhet të sigurojnë që të gjithë fëmijët/nxënësit të kryejnë arsimin fillor dhe të mesëm falas, të drejtë dhe cilësor, duke çuar në rezultate të rëndësishme dhe efektive të të nxënësve²².

Avokati i Popullit e ka evidentuar edhe më herët, mospërmbyshjen e standardeve bashkëkohore të disa mjediseve të institucioneve të edukimit, (edhe kur ato janë rikonstruktura), për të garantuar arsim cilësor në përputhje me nevojat e nxënësve.

²⁰ VKM nr. 621, datë 22.10.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021–2026 dhe të Planit të Veprimit për zbatimin e saj, linku: https://arsimiparauniversitar.gov.al/wp-content/uploads/2021/12/Vendim-621_date-22.10.2021_Per-miratimin-e-SKA-2021-2026.pdf, Produkti A.2.4 Përmirësimi dhe përshtatja e infrastrukturës shkollore A.2.4.1 Investime për përmirësimin dhe përshtatjen e infrastrukturës shkollore bazuar në parimet e dizajnit universal, të targetuar dhe të specializuara, duke konsideruar nevojat individuale të çdo nxënësi bazuar në parimet e modelit të hapësirave zhvillimore (për shkollat e reja ose për shkollat me mundësi rindërtimi/përshtatjeje). Përparësi do t’u jepet rindërtimit dhe rinovimit të godinave të dëmtuara nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019, si dhe *ndërtimit të godinave të reja shkollore në zonat urbane*, ku përqendrimi i nxënësve është i madh, në mënyrë që brenda vitit 2025, të mos ketë asnjë shkollë me dy turne. *Infrastruktura e re do të jetë në përputhje me normat dhe standardet për ndërtimin e godinave shkollore, duke ofruar kushte për mësim cilësor dhe gjithëpërfshirës në shkolla.*

²¹ Shkronja “e”, e pikës 3, të nenit 18, të ligjit nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

²² Problematika e evidentuar nga Avokati i Popullit në vitin 2021 në Raportin sintezë për problematikën e evidentuarë në ushtrimin e të drejtës për arsim të fëmijës për t’u arsimuar gjatë pandemisë dhe në vijim të situatës dhe rekomandimet përkatëse,

<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20vjetor%20i%20veprimtari%20i%20arsimit%20n%20vitin%202021.pdf>

Komiteti i OKB “Për të Drejtat e Fëmijës” pas raportimit të shtetit shqiptar lidhur me zbatimin e detyrimeve të Konventës “Për të drejtat e fëmijës” (2023), në konkluzionet përfundimtare, “risjell në vëmendje komentin e tij të përgjithshëm nr. 19 (2016) mbi buxhetimin publik për realizimin e të drejtave të fëmijëve dhe, duke marrë parasysh objektivin 16.5 të OZHQ, ka rekomanduar për vendin tonë:

“9/a Kryerjen e një vlerësimi gjithëpërfshirës të nevojave buxhetore të fëmijëve dhe ndarjen e burimeve të duhura buxhetore, në përputhje me nenin 4 të Konventës, për zbatimin e të drejtave të fëmijëve dhe, në veçanti, rritjen e buxhetit të alokuar për *arsimin, shëndetin, veçanërisht për arsimin fillor, kujdesin shëndetësor dhe mbrojtjen sociale;*

9/b Të sigurohet buxhetim transparent dhe pjesëmarrës përmes dialogut publik, veçanërisht me fëmijët për financimin dhe llogaridhënien e duhur nga autoritetet vendore”²³.

39/a Të forcohet cilësia e arsimit...duke siguruar që shkollat të jenë të sigurt dhe të aksesueshme për të gjithë, si dhe të pajisura me infrastrukturën e duhur dhe teknologjinë arsimore (...).

11/c “T’i jepet përparësi zbatimit sistematik dhe efektiv të rekomandimeve të Avokatit të Popullit drejtuar autoriteteve të ndryshme shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës nga institucionet e shtetit”²⁴.

Për sa më sipër, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës në interesin më të lartë të tyre dhe, në zbatim të legjislacionit të mbrojtjes së fëmijës, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në fushën e arsimit dhe, në mbështetje të nenit 21, të ligjit nr.8454, datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, institucioni i Avokati i Popullit,

REKOMANDON:

²³ Pika 9, Vëzhgimet përfundimtare për Shqipërinë pas raportit 5 dhe 6,25 Shtator 2023, CRC/C/ALB/CO/5-6

²⁴ Pika 11/c, CRC/C/ALB/CO/5-6

-Marrjen e masave të menjëhershme, për krijimin e mjediseve të përshtatshme për edukimin efektiv, nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës shkollore, duke bërë të mundur ndërtimin e godinës së re të shkollës 9-vjeçare “Adem Bedalli” Peqin dhe shkollës 9-vjeçare Bishqem, për funksionimin normal të procesit të edukimit e arsimimit dhe mbrojtjen e një jetese të shëndetshme, mbështetur në interesin më të lartë të fëmijëve.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr. 8454, datë 4. 2.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandime, duhet t’i shqyrtojnë ato dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit, ndërmjet institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijës, lutemi shqyrtimin e këtij rekomandimi!

K O M I S I O N E R

OLTA ALIAJ